

PROCESVERBAL
nga seanca e 5-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 21.7.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr.Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pransishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Ivona Mufisheva, Goran Radunović, mr.Argjend Xhelili, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 5-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 12:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi sa vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të vazhdimit të parë të seancës së 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 11.7.2025.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 4-t të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 11.7.2025.
3. Shqyrtimi i Raporteve Tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 prilli deri më 30 qershor 2025.
4. Draft-Rregullore e Punës së Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
5. Draft-udhëzues për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për verifikimin e raporteve për transmetim të reklamave politike me pagesë.
6. Informacion për zbatimin e detyrimeve të shërbimeve mediatike për të siguruar qasje për personat me aftësi të kufizuara.
7. Propozim-rregullore për personat fizikë që ofrojnë shërbime mediatike audiovizuele me kërkesë (influencues / vlogerë / krijues).

8. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
9. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë, për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
10. Propozim për shlyerjen e kërkesave të vjetruara nga evidenca kontabël e të dhënave të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
11. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: mirëmbajtjeje adaptive dhe parandaluese të sistemit të regjistrimit elektronik të rrjeteve të komunikimit publik.
12. Propozim për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e 4 (katër) qasjeve përdorues në bazën elektronike të rregulloreve të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".
13. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 6 vota "pro" dhe një abstenim nga Viktor Pavlovski, miratoi Procesverbalin e vazhdimin të parë të seancës së 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 11.7.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 4-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 11.7.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Kryetari i Këshillit, mr. Stefanovski, njoftoi pikën e rendit të ditës në lidhje me shqyrtimin e Raporteve tremujore të punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 prilli deri më 30 qershor 2025. Ai informoi se nuk do të ketë votim për këtë pikë, pasi raportet janë dorëzuar ekskluzivisht si material informativ.

Z. Trajčevski theksoi se, për të siguruar transparencë në punën e saj, Agjencia ka detyrim ligjor që t'i paraqesë Këshillit raporte tremujore çdo tre muaj, me qëllim në kohë të ofrojë informacion për aktivitetet e ndërmarra në periudhën e kaluar. Gjithashtu, ai njoftoi se shpjegim të detajuar të përmbajtjes së raporteve do të japë udhëheqësja, Dragica Ljubevska.

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë, Shef Kabineti mr. Dragica Ljubevska, informoi se në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, drejtori është i detyruar t'i paraqesë Këshillit Raporte Tremujore për zbatimin e Programit Vjetor të Punës së Agjencisë, si dhe Raporte Tremujore për masat e ndërmarra në rastet e shkeljes së dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe

kushteve dhe detyrimeve të lejes. Në periudhën nga prilli deri në fund të qershorit 2025, Agjencia ka realizuar një sërë aktivitete të parashikuara në Programin Vjetor të Punës së Agjencisë për vitin 2025. U kryen mbikëqyrje të rregullta programore mbi pesë shërbime programore televizive kombëtare tokësore, gjashtë televizione rajonale dhe pesë televizione lokale komerciale, me qëllim monitorimin e respektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe të akteve nënligjore përkatëse. Në kuadër të mbikëqyrjeve, u konstatuan shkelje tek TV M, TV Tera dhe TV Festa në lidhje me rregullat për mbrojtjen e të miturve. TV Festa, TV Puls dhe TV Uskana nuk ka përmbushur detyrimet për transmetim të programit të krijuar burimor, nga ku TV Uskana ka shkelur dhe rregullin për përdorimin e gjuhës në program. Mbi të njëjtit transmetues është kryer dhe mbikëqyrje administrative në lidhje me detyrimin për publikim impresium, për qasje në informacion të përdoruesve dhe për identifikim të transmetuesit. Shkelje të këtyre detyrimeve u konstatuan vetëm tek TV Festa. Mbikëqyrje e rregullt administrative u krye mbi të gjithë transmetuesit, në lidhje me detyrimin për dorëzimin e raportit për zbatimin e detyrimeve të përcaktuar në lejen për transmetim. Është konstatuar se transmetuesit i kishin përmbushur detyrimin dhe në përgjithësi ishin brenda kornizës së koncepteve të tyre programore. Mbikëqyrje e rregullt programore u krye në 11 shërbime programore televizive në nivel shtetëror, në lidhje me detyrimet për transmetim të veprave audiovizuele evropiane, ku nuk u konstatuan shkelje. Udhëheqësja Ljubevska shpjegoi se në të gjitha rastet ku u konstatuan shkelje, Agjencia ka kryer mbikëqyrje kontrolli për përcaktim të veprimi pas shqiptimit të masës. U përcaktua se të gjithë transmetuesit vepruan sipas masave, përveç TV Klan Maqedoni, ku është konstatuar se nuk kishte përmbushur kushtet minimale kadrovike të nevojshme për kryerje të veprimtarisë. Agjencia ka kryer mbikëqyrje mbi të gjithë transmetuesit dhe në lidhje me detyrimet për sigurim të transparencës në punë - duke paraqitur të dhëna mbi strukturën e pronësisë, redaktorët, punën ekonomike, burimet e financimit dhe duke paraqitur regjistrim të publikimit në Agjenci, nga ku nuk u konstatuan shkelje. Të dhënat e dorëzuara u përdorën për kontroll të ndryshimeve të mundshme në strukturën e pronësisë nga transmetuesit pa njoftim paraprak të Agjencisë, nga ku nuk është konstatuar mosrespektim i dispozitave ligjore. Në interes të transparencës, u përgatit dhe u botua publikimi "Pronësia e Medias në vitin 2025", që është i disponueshëm në fueb-faqen e Agjencisë. Ajo informoi se mbikëqyrje për të njëjtat detyrime është kryer edhe në median e shkruar, ku nuk janë konstatuar shkelje. Në pjesën e mbikëqyrjes profesionale, përmendi se është kryer mbikëqyrje mbi RA Skver nga Kumanova, gjatë së cilës u konstatua se radioja i plotëson kushtet teknike dhe kadrovike. Ajo theksoi se Agjencia ka mbajtur disa takime në lidhje me arsimimin mediatik, duke përfshirë takime në kuadër të përgatitjeve për Ditët e Arsimimit Mediatik. Ajo shtoi se janë shpallur tre konkurse për dhënien e lejeve për transmetim në radio, për të cilat procedurat janë ende në vazhdim. Në pjesën e heqjes së lejeve, informoi se ka përfunduar një procedurë - për TV Klan, për shkak të mospërmbushjes së kushteve kadrovike dhe kompensimit të papaguar, dhe se televizioni është fshirë nga regjistri. Përveç kësaj, është fshirë edhe radioja universitare UGD Shtip, pas kërkesës së paraqitur për renoncim të lejes. Raportoi se me kërkesë u kryen katër mbikëqyrje mbi ofrues të shërbimeve mediatike audiovizuele, pa shkelje të përcaktuara. U kryen gjithashtu 14 mbikëqyrje mbi operatorë të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, ku shkelje u konstatuan vetëm te Total TV. U dhanë gjithsej 76 çertifikata për regjistrimin e paketave programore. Ajo deklaroi se në fillim të qershorit, në përputhje me ndryshimet në Ligjin për Median, është miratuar Rregullore për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në Regjistrin e Botuesve të Medias Online, dhe se në gjysmën e dytë të qershorit, Regjistri është krijuar dhe publikuar në ueb-faqen e Agjencisë. Ajo

theksoi se janë përgatitur tre studime për arsyeshmëri të shpalljes së konkurseve publike për radio lokale në Prilep, Strugë dhe Shtip. Përveç kësaj, është përgatitur analiza "Struktura e të punësuarve në industrinë e mediave audio dhe audiovizuele në vitin 2024" dhe studimi "Transmetuesit rajonalë dhe lokalë - arsyetimi dhe mundësitë për implementimin e masave mbështetëse". Në pjesën e bashkëpunimit ndërkombëtar, informoi se Agjencia iu përgjigj disa pyetësorëve nga Platforma Evropiane e Organeve Rregullatore (EPRA) dhe se përfaqësuesit e saj morën pjesë në takimin e 61-të të EPRA-s, të mbajtur në Moldavi. U mbajtën dhe takime pune me IFES dhe OBSE/ODIHR, dhe vuri në dukje finalizimin e specifikimit teknik për përgatitjen e një aplikacioni për monitorimin e reklamave politike me pagesë gjatë proceseve zgjedhore. Aplikacioni do të financohet nga IFES. Takime pune u mbajtën dhe me Këshillin e Evropës në kuadër të projektit PROFREKS, për përgatitjen e Studimi mbi zbatimin e inteligjencës artificiale në proceset e punës nga media. Ajo theksoi se ka pasur edhe takime me organizata të tjera, detajet e të cilave janë renditur në raportin e paraqitur. Gjithashtu informoi se Agjencia kontribuoi në Raportin Vjetor të Komisionit Evropian për Kapitullin 10 - Shoqëria e Informacionit dhe Media dhe Kapitullin 23 – Të drejtat, Liria dhe Siguria, si dhe në finalizimin e Udhërrëfyesit për Sundimin e të Drejtës – në pjesën mbi funksionimin e institucioneve demokratike. Theksoi se është mbajtur takimi i dytë publik i Agjencisë për vitin 2025, në të cilin është prezantuar përmbledhja e aktiviteteve në tremujorin e dytë dhe janë prezantuar rezultatet e analizës "Gjinia në Media në vitin 2024". Theksoi se pjesë integrale e Raportit është raporti i performancës financiare për tremujorin e dytë, për të cilin do të raportohet shtesë nga kolegu Radunoviq. Së fundmi, informoi se në periudhën raportuese, janë shqiptuar gjithsej 14 paralajmërime publike transmetuesve dhe një paralajmërim publik operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik. Është zbatuar një procedurë zgjidhjeje, e cila përfundoi me pagesën e një gjobe në afatin e parashikuar dhe është paraqitur një kërkesë për procedurë kundërvajtëse, e cila është në shqyrtim para gjykatës kompetente.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, z. Goran Radunoviq, shpjegoi Raportin Tremujor Financiar për muajt prill, maj dhe qershor 2025. Gjatë kësaj, ai informoi për të ardhurat dhe shpenzimet totale të realizuara në tremujorin e dytë. Në pjesën e të ardhurave nga buxheti, ai theksoi se këto janë mjete që Agjencia i merr çdo muaj nëpërmjet Ministrisë së Transformimit Digjital, nga ku çdo muaj transferohen në shumë prej 6.572.208,00 denarësh. Në lidhje me të ardhurat nga lejet e dhëna, ai theksoi se në periudhën e lartpërmendur (prill-qershor) janë realizuar të ardhura në vlerë prej 10 milionë denarësh, pasi në këtë tremujor realizohet dhënia e lejeve. Përveç kësaj, ai informoi se janë realizuar të ardhura nga mbikëqyrja, duke pasur parasysh se faturat për mbikëqyrjen e operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik janë dhënë në muajin prill dhe janë paguar plotësisht përkatësisht të gjithë pagesit i kanë rregulluar detyrimet e tyre në tërësi. Ai theksoi se raporti përfshin të ardhura nga të ashtuquajturat fatura tranziti, të cilat rrjedhin nga faturat e dhëna ndaj Ministrisë së Sportit. Këto janë shpenzime të përbashkëta lidhur me energjinë elektrike, mirëmbajtjen e sistemeve të ftohjes dhe ngrohjes, menaxhimin e ashensorit, platformën, si dhe pajisjet e mbrojtjes nga zjarri (aparaturat PP). Në lidhje me shpenzimet, ai theksoi se të gjitha shpenzimet e kryera në tremujorin e dytë janë në përputhje me kontratat e lidhura për furnizim publik dhe janë brenda kornizës së shpenzimeve të parashikuara në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025.

Këshilltarja znj. Vërzivolli theksoi se pika e tarifës së anëtarësimit tregohet me një vlerë zero dhe pyeti nëse parashikohet pagesë në periudhën e ardhshme bazuar në tarifën e anëtarësimit.

Udhëheqësi Radunoviq sqaroi se Agjencia ka vetëm një detyrim mbi këtë bazë, dhe është tarifa e anëtarësimit për Platformën Evropiane të Rregullatorëve (EPRA), në të cilën Agjencia është anëtare si rregullator kombëtar. Ai shtoi se tarifa vjetore e anëtarësimit për EPRA tashmë është rregulluar gjatë tremujorit të parë të vitit.

Përveç kësaj, znj. Vërzivolli vuri në dukje se është evidentuar një tepricë mjetesh dhe kërkoi sqarim për prejardhjen e tyre.

Udhëheqësi Radunoviq informoi se fondet e tepërta rrjedhin nga pagesa e planifikuar e tarifave të anëtarësimit për revizor i cili është punësuar nga Agjencia, por për shkak se ai u largua nga institucioni, fondet e planifikuara për atë qëllim mbetën të papërdorura.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Draft-Rregulloren e Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ai theksoi se teksti i Rregullores së Punës gjatë kësaj periudhe është përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e Këshillit, të cilët ishin plotësisht të njoftuar me ndryshimet e bëra në lidhje me Rregulloren ekzistuese të Punës. Ai theksoi se, në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Draft-Rregullorja e Punës aktualisht është duke u shqyrtuar në formë të draft-dokumenti dhe do t'i nënshtrohet një debati publik për një periudhë prej 30 ditësh. Pas përfundimit të debatit publik, Rregullorja e Punës duhet të miratohet në afat prej 60 ditësh nga dita e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, në përputhje me dispozitat ligjore.

Këshilltarja Cvetanka Minovska kërkoi sqarime në lidhje me nenin 9 të Draft-dokumentit, i cili thotë: "Funksionimi i Agjencisë financohet nga fondet e sigurara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të ardhurat e kompensimeve të parashikuara në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), si dhe nga kreditë dhe ndihma të tjera financiare dhe teknike." Në fjalimin e saj, ajo e drejtoi vëmendjen te pjesa që lidhet me kreditë dhe ndihmat e tjera financiare dhe teknike, me qëllim që të sqarohet në mënyrë më të detajuar.

Z. Trajçevski shpjegoi se përmbajtja e nenit 9 përcaktohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Në prezantimin e tij, ai përmendi një shembull konkret nga e kaluara, kur gjatë ndërtimit të objektit në të cilin ndodhet aktualisht Agjencia, për shkak të mungesës së mjeteve të mjaftueshme financiare, u mor një kredi nga njëra prej bankave komerciale. Kjo kredi i mundësoi Agjencisë të kryejë me kohë detyrimet që lidhen me ndërtimin e objektit. Në këtë kontekst, z. Trajçevski theksoi se, nëse lind nevoja, Agjencia ka mundësinë të kërkojë kredi ose formë tjetër të mbështetjes financiare. Lidhur me ndihmën teknike dhe financiare, ai tregoi se më shpesh bëhet fjalë për projektet IPA që janë zbatuar në të kaluarën, dhe aktualisht ka njoftim dhe për mbështetje të re nga Komisioni Evropian. Së fundmi, z. Trajçevski theksoi se përmbajtja e nenit është marrë nga dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).

Znj. Minovska kërkoi gjithashtu sqarime në lidhje me nenin 15 të Draft-Rregullores së Punës, i cili i referohet kompetencave të Këshillit të Agjencisë. Ajo iu referua konkretisht njërit prej nënparagrafëve, i cili parashikon: "- miratimi i Kodeksit të sjelljes për anëtarët e Këshillit dhe të punësuarve në Shërbimin Profesional të Agjencisë." Znj. Minovska pyeti nëse ky formulim mund të përfshinte edhe "drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e Agjencisë", pasi, sipas saj, nuk është e qartë nëse edhe ato janë përfshirë.

Z. Trajçevski sqaroi se drejtori dhe zëvendësdrejtori janë të punësuar në Shërbimin Profesional të Agjencisë. Megjithatë, propozoi që të kryhet kontroll shtesë në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), i cili përcakton kompetencat e Këshillit, me qëllim shmangien e keqkuptimeve të mundshme.

Znj. Minovska arriti në përfundimin se, nëse drejtori dhe zëvendësi i tij janë vërtet pjesë e Shërbimit Profesional, atëherë nuk ka vërejtje në lidhje me formulimin.

Udhëheqësja mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi se ky formulim është përcaktuar në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), konkretisht në nenin 18, i cili i referohet kompetencave të Këshillit. Neni i lartpërmendur thotë se: "- miraton Kodeks të sjelljes për anëtarët e Këshillit dhe të punësuarit në Shërbimin Profesional të Agjencisë."

Zëvendës kryetarja e Këshillit Zirjeta Jajaga propozoi që në nenet 21, 23, 24 dhe 99 të Draft-Rregullores së Punës, aty ku thuhet "drejtori i Agjencisë", të shtohet dhe "zëvendësdrejtori i Agjencisë".

Z. Trajçevski vuri në dukje se ndryshimi i propozuar do të evidentohet si vërejtje të Draft-dokumentit. Ai shpjegoi se sistemi i regjistrimit e regjistron vërejtjen dhe se plotësuese do të shqyrtohet përputhshmëria e propozimit me dispozitat e Ligjit. Pas analizës, Agjencia do të paraqesë shpjegim gjatë miratimit të versionin përfundimtar të Rregullores së Punës, i cili do të përcaktojë nëse formulimi i propozuar mund të futet. Në këtë drejtim, z. Trajçevski theksoi se në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) nuk përdoret terminologjia "zëvendësdrejtor", por "zëvendës i drejtorit", që do të thotë se zëvendësdrejtori zëvendëson drejtorin në mungesë të tij. Ai përmendi një shembull konkret se, kur drejtori mungon për shkak të udhëtimit zyrtar ose për arsye tjetër, zëvendësi automatikisht merr përsipër funksionin e tij, nga ku dispozitat e Rregullores së Punës vlejnë edhe për të.

Znj. Minovska, lidhur me propozimin e znj. Jajaga, theksoi se kjo çështje është shpjeguar në nenin 42 të Draft-Rregullores së Punës, i cili thotë si vijon: "Zëvendës i drejtorit të Agjencisë e zëvendëson drejtorin e Agjencisë në rast nëse ai mungon ose kur, për shkakake shëndetësore ose arsyeve të tjera, nuk është në gjendje të kryejë funksionin e tij, për të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e tij udhëheqëse. Në bashkëpunim me drejtorin e Agjencisë, zëvendësdrejtori kryen detyra në kompetencë të drejtorit të Agjencisë, të cilat ai do t'ia besojë." Në këtë drejtim, znj. Minovska kërkoi sqarim shtesë të fjalisë së dytë, përkatësisht nëse kjo do të thotë që drejtori i Agjencisë i beson detyra konkrete pune zëvendësit në kuadër të kompetencave të tij.

Z. Trajçevski u përgjigj se shpjegimi i tij ishte dhënë në përputhje me formulimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të cilin ai e kishte shpjeguar më parë, dhe se në fakt po flisnin për të njëjtën çështje.

Këshilltarja Gordana Majnova propozoi plotësim të nenit 41 të Draft-Rregullores së Punës, konkretisht në paragrafin e parafundit, i cili thotë: "Drejtori është i detyruar Këshillit t'i paraqesë Raporte Tremujore mbi zbatimin e programit vjetor të punës së Agjencisë, si dhe Raporte Tremujore mbi masat e ndërmarra në përputhje me LSHMAAV, në rast të shkeljes së dispozitave të LSHMAAV, LM ose të dispozitave të miratuara në bazë të tyre dhe kushtet dhe detyrimet e lejeve."

Znj. Majnova theksoi se ky formulim ishte marrë nga Rregullorja ekzistuese e Punës nga vitit 2019, por se në Draft-Rregulloren është lënë jashtë pjesë e tekstit, të cilën ajo e konsideronte të rëndësishme. Konkretisht, ajo propozoi pas fjalës "lejet" të shtohej sa vijon:

“dhe të cilat përmbajnë raporte mbi aktivitetet ndërkombëtare të Agjencisë dhe aktivitetet e planifikuara në periudhën e ardhshme”, me qëllim që kjo të përfshihej përsëri në tekstin e ri të Rregullores së Punës.

Z. Trajçevski deklaroi se propozimi është i pranueshëm, por se duhet propozimi të shqyrtohet si propozim formal, duhet të zhvillohen konsultime me sektorin juridik dhe se përgjigje do të jepej në kohën e duhur.

Znj. Minovska propozoi plotësim të nenit 43 të Draft-Rregullores së Punës, i cili thotë: “Në rast nevojë për punësim në Shërbimin Profesional të Agjencisë, drejtori paraqet propozim Këshillit për miratimin e vendimit për shpallje të konkursit për vend të lirë pune dhe për zbatimin e procedurës për punësim në Shërbimin Profesional. Pas marrjes së miratimit, drejtori miraton vendim për shpallje të njoftimit për vend të lirë pune...”. Znj. Minovska propozoi në tekst të shtohet formulimi i mëposhtëm: “dhe së bashku me Këshillin e Agjencisë, formon Komision për përzgjedhjen e kandidatit që do të jetë në marrëdhënie pune. Përveç kësaj, ajo propozoi në fjalinë vijuese të shtohet “pas konsultimit paraprak me Këshillin e Agjencisë”, në mënyrë që e gjithë fjalia të lexohet: “Drejtori i Agjencisë vendos për shpërndarjen e të punësuarve në Shërbimin Profesional të Agjencisë, pas konsultimit paraprak me Këshillin e Agjencisë.”

Z. Trajçevski shpjegoi se e vetmja paralele që mund të bëhet në nenin e propozuar është sipas Ligjit për furnizim publik. Ai sqaroi se Këshilli ka rol në dhënien e miratimit për zbatimin e furnizimit publik, ndërsa përgjegjësia për zbatim i takon Shërbimit profesional dhe drejtorit. Sipas mendimit të tij, nuk ka pengesë nëse Këshilli dëshiron të krijojë Komision për përzgjedhjen e të punësuarve, por theksoi se, sipas Ligjit, Agjencia funksionon sipas sistemi vendimmarrjeje me dy nivele . Ai shpjegoi se Këshilli vendos për shkarkimin e punonjësve ose kur shqiptohen lloje të ndryshme masash, siç paralajmërimë, gjobat ose shkarkimet nga puna, që është e rëndësishme për ruajtjen e parimit të vendimmarrjes me dy nivele. Z. Trajçevski theksoi se, nëse Këshilli merr pjesë edhe në përzgjedhjen e punonjësve, hapet pyetja se si do të veprohet në pjesën e ndëshkimeve. Ai theksoi se, nëse drejtori merr aktvendim për shkarkimin e punonjësti, ky aktvendim nuk është i formës së prerë nëse nuk konfirmohet nga Këshilli. Për ankesat dhe vendimet përfundimtare vendos Këshilli, pas të cilave ekziston mundësia e mbrojtjes gjyqësore nga personi që mendon se nuk është vepruar drejtë. Ai shtoi se ky sistem përfaqëson princip të vendimmarrjes në dy faza që duhet të respektohet. Ai gjithashtu shpjegoi se në Agjenci punësimet janë të rralla dhe zakonisht komisioni përfshin udhëheqës të sektorëve ose zëvendës të tyre, varësisht nga fusha konkrete. Z. Trajçevski theksoi se deri më tani nuk është vepruar në kundërshtim me propozimin për formimin e komisioni për përzgjedhjen e punonjësve dhe se mund t'i kërkohej shërbimit juridik të paraqesë të gjitha njoftimet dhe dokumentet që lidhen me përzgjedhjen e personave të pranuar. Ai sqaroi se Komisioni gjithmonë zgjedh kandidatin më të përshtatshëm dhe se asnjëherë nuk është pranuar kandidat që nuk ishte më i miri në renditje, përkatësisht asnjëherë nuk ka ndodhur të jetë pranuar kandidat që është në vendin e tretë. I gjithë procesi kryhet në përputhje me vendimet që lidhen me procedurat e furnizimit publik për punësim.

Znj. Minovska theksoi se pavarësisht shpjegimeve, mendon se duhet të gjendet një zgjidhje e përshtatshme nëse vendosja e punonjësve në Shërbimin Profesional duhet të jetë "në bashkëpunim" ose "së bashku me Këshillin". Ajo gjithashtu propozoi gjatë vendosjes (shpërndarjes) duhet të thuhet se kjo bëhet "në konsultim me Këshillin".

Z. Trajčevski u përgjigj se vendosja në detyrë është kompetencë ekskluzive e drejtorit, i cili është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Agjencisë, si dhe për avancimin në detyrë ose uljen në detyrë të punonjësve. Ai sugjeroi që, nëse Këshilli e konsideron të nevojshme, mundë të vendoset një praktikë në Raportet Tremujore të informohen për punonjësit që janë avancuar në detyrë ose janë ulur në detyrë. Përveç kësaj, ai shpjegoi se nëse dikush shkarkohet nga puna, kjo duhet të konfirmohet nga Këshilli, në mënyrë që Këshilli gjithmonë të informohet në kohë për vendime të tilla.

Znj. Minovska u kërkoi anëtarëve të Këshillit të deklarojnë nëse e pranojnë propozimin në Raportet tremujore të përfshihen informacione se cili punonjës është avancuar në detyrë dhe kush është riemëruar në pozicion më të ulët.

Znj. Jajaga propozoi që propozimi të shënohej, të shqyrtohet më tej dhe të përcaktohet se si do të zbatohet në praktikë.

Z. Pavlovski theksoi se së pari është e nevojshme të kontrollohet nëse ekzistojnë baza ligjore për këtë lloj raportimi dhe se, përpara se të fillojë diskutimi, shërbimi juridik duhet të japë mendim mbi këtë çështje.

Z. Trajčevski shpjegoi se, megjithëse një detyrim i tillë ligjor nuk ekziston, ekziston gatishmëri që Këshilli të informohet plotësisht, duke marrë parasysh se Agjencia vepron në mënyrë transparente dhe nuk ka ndërmend të fshehtë ndonjë të dhënë.

Z. Xhurovski shtoi se duke përfshirë informacione të tilla në Raportet Tremujore, Këshilli vetëm do të informohet, pa pasur ndonjë detyrim shtesë ose rol vendimtar.

Znj. Vërzivolli i bëri pyetje drejtorit në lidhje me procesin e vlerësimit të punonjësve, duke marrë parasysh se pikërisht në bazë të rezultateve të vlerësimit merren vendime në lidhje me avancimin ose uljen në detyrë të tyre.

Z. Trajčevski shpjegoi se vlerësimi kryhet dy herë në vit — për gjashtëmujorin e parë dhe të dytë. Për punonjësit në sektorë, raportet e vlerësimit përgatiten nga udhëheqësi i sektorit, ndërsa për udhëheqësit e sektorit, vlerësimi kryhet nga drejtori i Agjencisë. Në bazë të këtyre raporte gjashtëmujore të punës, kryhet procesi i avancimit në detyrë ose uljes në detyrë të punonjësve.

Znj. Majnova propozoi fshirjen e plotë të paragrafit 3 të nenit 106, i cili thotë: “Anëtarët e Këshillit bashkëpunojnë me punonjësit e Shërbimit Profesional, dhe kërkesat për kryerjen e detyrave të punës nga Shërbimi profesional, që lidhen me kompetencat e Agjencisë, i përcillen drejtorit.” Ajo e shpjegoi propozimin duke deklaruar se çështja e lartpërmendur është rregulluar tashmë në detaj nga Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë dhe Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe punën dhe për këtë arsye vlerësoi se paragrafi është i tepërt.

Z. Trajčevski u përgjigj se edhe kjo vërejtje do të shënohet dhe do të shqyrtohet plotësisht, nga ku Këshilli do të marrë shpjegim shtesë nëse fshirja e propozuar është e pranueshme.

Z. Stefanovski bëri vërejtje teknike në lidhje me nenin 97, i cili thotë: “Klasifikimi ose deklasifikimi i informacionit kryhet nga drejtori i Agjencisë, në përputhje me rregulloret ligjore pozitive në Republikën e Maqedonisë së Veriut që rregullojnë këtë çështje.” Ai propozoi në tekst të shtohet se klasifikimi dhe deklasifikimi i informacionit kryhet “me miratim paraprak nga Këshilli i Agjencisë”.

Z. Trajçevski u përgjigj se për momentin nuk mund të japë qëndrim konkret mbi propozimin, por se vërejtja do të shënohet, do të shqyrtohet dhe do të bëhen konsultime, pas së cilës do të dorëzohet përgjigje përkatëse. Në lidhje me procesin e votimit, ai sqaroi se Këshilli duhet ta pranojë tekstin e Draft-Rregullores së Punës në formën e tij aktuale, duke vënë në dukje(shënuar) të gjitha vërejtjet dhe propozimet e bëra nga anëtarët, mbi të cilat Shërbimi Profesional do të deklarohet në kohë dhe do t'i informojë anëtarët e Këshillit.

Z. Stefanovski shtoi se Draft-Rregullorja e Punës do të vihet në debat publik në afat prej 30 ditësh, në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të kenë mundësinë të paraqesin propozime shtesë.

Znj. Majnova kërkoi sqarime nëse të gjitha vërejtjet dhe propozimet e dhëna nga anëtarët e Këshillit sot duhet të përpunohen dhe të përfshihen në Draft-Rregulloren e Punës, pas së cilës i gjithë teksti do të publikohet në ueb-faqe për debat publik prej 30 ditësh ose debati publik do t'i referohet vetëm versionit të tekstit të propozuar sot?

Z. Trajçevski u përgjigj se në parim teksti do të publikohet në formën e propozuar, pasi është një draft, ndërsa vërejtjet e Këshillit regjistrohen. Ai sqaroi se deri më tani vërejtjet e anëtarëve të Këshillit nuk janë publikuar në ueb-faqe, sepse anëtarët kanë mundësi të vazhdueshme për të komunikuar me Shërbimin Profesional, ku mund t'i japin vërejtjet e tyre, si dhe të votojnë kur merren vendime. Megjithatë, nëse Këshilli këmbëngul ose kërkon, nuk ka pengesë që vërejtjet të publikohen në ueb-faqe.

Znj. Majnova tregoi se kishte shqyrtuar linkun nga ueb-faqja e vitit 2014, nga e cila mund të vërehet se anëtarët e Këshillit dhe atëherë kanë dhënë komente për Draft-dokumentin.

Z. Trajçevski u përgjigj se vërejtjet dhe propozimet që anëtarët e Këshillit paraqitën sot, megjithëse disa ishin në formë diskutimi, dhe jo si vërejtje të përcaktuara saktësisht, janë regjistruar nga Agjencia. Ai shtoi se ato do të shqyrtohen dhe do të jepet përgjigje për statusin e tyre ligjor. Ai gjithashtu theksoi se çdo anëtar i Këshillit mund të paraqesë propozime konkrete nëpërmjet linkut që është i hapur për debat publik.

Znj. Majnova pyeti nëse do të ishte më e përshtatshme të rishikohet Draft-Rregullorja të revidohet duke përfshirë vërejtjet nga anëtarët e Këshillit dhe më pas ky version të vihej në debat publik.

Z. Trajçevski shpjegoi se Draft-Rregullorja e Punës është aktualisht në formën e propozuar dhe se nuk është e mundur menjëherë të deklarohet nëse vërejtjet do të pranohen. Ai theksoi se shërbimi duhet t'i shqyrtojë ato individualisht dhe t'u japë përgjigje secilës prej tyre. Ai gjithashtu theksoi se nëse Këshilli dëshiron, vërejtjet mund të publikohen në ueb-faqe në kuadër të linkut për debat publik, ku Agjencia është e detyruar të deklarojë nëse i pranon apo i refuzon ato, dhe ta shpjegojë këtë. Të gjithë ata që paraqesin komente do t'i jepet shpjegim për pranim ose refuzim.

Z. Stefanovski tha se pajtohet që Draft-Rregullorja e Punës të vihet në debat publik me tekstin e propozuar, ndërsa komentet do të shqyrtohen dhe do të jepet shpjegim nëse ato do të pranohen ose jo.

Këshilli i Agjencisë, me 6 vota "pro" dhe një abstenim nga znj. Majnova, miratoi Draft-Rregulloren e Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me tekstin e propozuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-rregulloren e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë, me qëllim që të ofrojë debat publik në kohëzgjatje prej 30 ditësh, për t'u mundësuar të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Janevska, shpjegoi Draft-Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për konfirmimin e raporteve për transmetim të reklamave politike me pagesë. Ajo shpjegoi se përveç monitorimit të reklamave politike me pagesë, Kodi Zgjedhor e detyron Agjencinë të konfirmojë edhe raportet e transmetuesve mbi shërbimet e ofruara, për transmetim të reklamave politike me pagesë. Raportet konfirmohen në afat të shkurtër kohor prej pesë ditësh nga dorëzimi i tyre, dhe këto raporte për shërbimet e realizuara, transmetuesit i dorëzojnë si shtojcë të faturave që i dorëzojnë në Komisionin Shtetëror Zgjedhor për pagesën e shpenzimeve të tyre për transmetim. Në pritje të zgjedhjeve të ardhshme lokale, të planifikuara për tetor të këtij viti, është e nevojshme të ndryshohet Udhëzimi për konfirmimin e raporteve, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me ndryshimet e mëparshme të Kodit Zgjedhor dhe me praktikën e Agjencisë. Në Draft-Udhëzim janë propozuar katër ndryshime kryesore. Dy prej tyre lidhen me ndryshimet e mëparshme të Kodit Zgjedhor, dhe dy janë rezultat i përvojës. Ndryshimet e mëparshme të Kodit Zgjedhor i referohen paragrafëve 4 dhe 5 të Kapitullit 1 "Dispozita të Përgjithshme" dhe paragrafit 2 në Kapitullin 5 "Raporti mbi shërbimet e kryera". Ato lidhen me afatin e pagesës së shpenzimeve për transmetimin e reklamave politike me pagesë nga KSHZ, i cili nuk është më 30 ditë nga fillimi i heshtjes parazgjedhore, por është 30 ditë nga shpallja e rezultateve përfundimtare, si dhe me faktin se formularët për planet mediatike dhe për "Raportin mbi shërbimet e kryera" miratohen nga KSHZ, dhe jo nga Agjencia siç thuhet në Udhëzimin ekzistues. Ndërsa ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në Kapitullin 2, "Informimi i Agjencisë për kontratat e lidhura" dhe Kapitullin 3 "Dorëzimi i regjistrimeve të programit", lidhen me praktikën tonë të mëparshme. Ato i referohen mënyrës së paraqitjes së media planeve dhe regjistrimit të programeve. Deri më tani, transmetuesit kanë paraqitur media planet, menjëherë sapo i kanë marrë nga pjesëmarrësit në zgjedhje, por praktika ka treguar dallime të mëdha në planifikim dhe në transmetimin e reklamave politike me pagesë, përpara se transmetuesit të kenë pasur mundësinë t'i kontrollojnë. Me ndryshimin e propozuar kërkohet që transmetuesit të paraqesin media planet, pasi të kenë kontrolluar nëse transmetimi ishte në të vërtetë në përputhje me planin. Ndryshimi i dytë ka të bëjë me metodën e dorëzimit të regjistrimit të programit. Në udhëzimin ekzistues kishin një skemë të përgatitur se sa ditë secili transmetues duhet të dorëzojë regjistrime. Agjencia aktualisht përdor një metodë më efikase për dorëzimin e regjistrimeve, ku transmetuesit i ngarkojnë regjistrimet direkt në një server të krijuar nga Agjencia, i cili mundëson qasje të përditshëm me emër përdoruesi dhe fjalëkalim. Kjo metodë e dorëzimit të regjistrimeve u realizua sepse metoda e mëparshme e zgjat shumë procesin e monitorimit, pasi që kishte nevojë për kohë shtesë për të shkarkuar regjistrimet që dorëzoheshin me e-mail, dhe burime njerëzore për të organizuar regjistrimet në mënyrë që ato të mund të rishikohen më vonë. Këto janë ndryshimet kryesore në udhëzim dhe propozohet që Këshilli të miratojë Draft-Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit për konfirmimin e raporteve mbi reklamat politike me pagesë të transmetuara, të cilat do të publikohen në ueb-faqen e Agjencisë dhe do të hapin debat publik në kohëzgjatje prej 45 ditësh, e cila duhet të përfundojë në fillim të shtatorit, që është kohë e mjaftueshme që

palët e interesuara të deklarohen dhe do të ketë kohë që Këshilli ta miratojë në formën përfundimtare, sepse ky udhëzues është i nevojshëm për periudhën e fushatës zgjedhore kur transmetohet reklama politike me pagesë dhe për këto zgjedhje pritet të jetë diku në fund të shtatorit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi Draft-Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për Konfirmimin e raporteve për transmetimin e reklamave politike me pagesë, nr.01-2544/1 datë 15.6.2020, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-udhëzimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë, me qëllim që të sigurojë debat publik në kohëzgjatje prej 45 ditësh, për t'u mundësuar të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Pika 6

Udhëheqësja Janevska shpjegoi Informacionin mbi zbatimin e detyrimeve të shërbimeve mediatike për të siguruar qasje për personat me aftësi të kufizuara. Ajo shpjegoi se me ndryshimet në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nga korriku 2023, u forcuan dispozitat e ofruesve të shërbimeve mediatike në drejtim të sigurimit të qasjes në përmbajtjet e tyre për personat me aftësi të kufizuara shqisore. Ajo kujtoi se këto detyrime të përforcuara nënkuptojnë miratimin e planeve vjetore të veprimit për qasje, të cilat ofruesit e shërbimeve duhet t'i miratojnë deri më 31 dhjetor dhe dorëzimin e raportit vjetor për zbatimin e planit të veprimit, të cilin e dorëzojnë deri më 31 mars të vitit aktual. Ajo deklaroi se ky vit 2025 është viti i parë për të cilin ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale kanë dorëzuar plane vjetore të veprimit për qasje. Ajo theksoi se detyrimi për qasje është përpunuar me Rregulloren të veçantë për qasje në shërbimet mediatike, e cila është e disponueshme nëpërmjet linkut në vetë Informacionin dhe e publikuar në ueb-faqen e Agjencisë. Përmbledhja e të gjitha programeve të planifikuara që do të bëhen të qasshme, e cila është bërë në bazë të planeve vjetore të veprimit, gjithashtu është e disponueshme në ueb sajtin e Agjencisë në pjesën për qasjen e shërbimeve mediatike në baner të veçantë që përditësohet vazhdimisht. Ajo shpjegoi se detyrimi për të paraqitur plane vjetor veprimi për qasje është vetëm për televizionet kombëtare komerciale, tre shërbimet televizive të shërbimit publik radiodifuziv, RTM1, RTM2 dhe RTM5, dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, të cilët janë persona juridikë. Nga transmetuesit në nivel rajonal dhe lokal pritet të përpiqen të transmetojnë përmbajtje me qasje, të cilën mund të përgatën edhe nga transmetues të tjerë nga vendi, dhe në pajtim me Rregulloren nuk janë të detyruar të paraqesin plane veprimi. Kjo mbikëqyrje vlen vetëm për televizionet në nivel shtetëror, sepse për ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, duhet të kalojë një vit që të mund të llogaritet përqindja. Sipas Rregullores, televizionet që transmetojnë programe në nivel shtetëror, në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të Rregullores, janë të detyruar të bëjnë qasje së paku në një program, dhe çdo vit pasues të rrisin numrin e programeve, në mënyrë që të arrijnë efekt kumulativ. Ndërkohë, ofruesit e shërbimeve me kërkesë janë të detyruar të sigurojnë qasje prej 2% të katalogut të tyre, që do të thotë se duhet të kalojë viti aktual, që të mund të verifikohet nëse 2% e katalogut është bërë i qasshëm për personat me aftësi të kufizuara. Të gjitha subjektet, të gjitha televizionet kombëtare, RTM dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, në afatin ligjor, disa pak më vonë, dorëzuan plane vjetore veprimi. Plan vjetor veprimi

nuk dorëzoi vetëm A1 Maqedoni, e cila fillimisht njoftoi, dhe tani me shkresë të datës 10 korrik raportoi se kishte ndaluar ofrimin e shërbimit mediatik audiovizual video me kërkesë, që do të thotë se në përmbledhjen që do të publikohet në ueb-faqen, për video shërbime me kërkesë ka informacion për tre operatorë. Mbikëqyrja u krye në dy periudha, sepse është detyrim i ri dhe për të marrë të dhëna më gjithëpërfshirëse, një në maj, një në qershor, janë dhënë konstatime nga mbikëqyrja për secilin medium në veçanti për dy mbikëqyrjet. Në përgjithësi, mund të konstatohet se shumica e mediave e kanë përmbushur detyrimin dhe atë që kishin planifikuar në planet vjetore të veprimit. Vetëm Nasha TV, dhe në periudhën e parë ashtu edhe në periudhën e dytë, nuk e respektoi planin e saj vjetor të veprimit, përkatësisht nuk ka ofruar qasje në programin e saj për personat me aftësi të kufizuara. Në stacione të tjera televizive, diku janë konstatuar devijime të vogla në lidhje me kohën e transmetimit, në disa raste pati devijime më të rëndësishme në lidhje me mostransmetimin e disa përmbajtjeve. Aktivitetet që pasojnë këtë informacion janë: Nasha TV do të marrë njoftim se duhet të përmbushë detyrimet ligjore, të gjithë transmetuesve do t'u dërgohet shkresë me të cilën do të informohen për konstatimet e mbikëqyrjes dhe do të kërkohet prej tyre të harmonizojnë planet e tyre vjetore të veprimit me kohët reale të transmetimit të përmbajtjeve të qasshme. Gjithashtu do të kërkohet për të gjitha ndryshimet në skemat e programit, në kohë të informojnë Agjencinë që të mundë në kohë të përditësohet shikueshmëria që është në ueb sajtin, që është bërë për të mundësuar personat me aftësi të kufizuara në një vend të kenë informacion se cilat përmbajtje janë të qasshme. Gjithashtu do të kujtohen se kanë detyrim për të njoftuar në program përmbajtjet e qasshme para transmetimit të tij. Gjithashtu janë konstatuar dhe dy çështje për këtë mbikëqyrje, dhe kjo është se nëse përdorin përkthyes të gjuhës së shenjave, ekrani i ndarë me përkthyes duhet të jetë së paku dy herë më i madh, që është detyrim sipas Rregullores. Ky nuk ishte rasti me të gjithë transmetuesit, dhe për sa i përket titimit është e dëshirueshme të shfrytëzojnë fond për të qenë mjaftueshëm i dukshëm, gjë që gjithashtu nuk ishte rast me të gjithë transmetuesit.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva shpjegoi Propozim-rregulloren për personat fizikë që ofrojnë shërbime mediatike audiovizuale me kërkesë (influencers/vlogerë/krijues). Ajo shpjegoi se me ndryshimet në LSHMAAV nga korriku 2023, si lëndë e rregullativës përfshihen dhe personat fizikë që janë ofrues të shërbimeve mediatike audiovizuale. Për shkak të specifikave të natyrës së veprimtarisë, ligjvënësi ka parashikuar detyrim për Agjencinë që të përcaktojë mënyrën e njohjes së këtyre personave fizikë që do të konsiderohen ofrues të shërbimeve të tilla. Në këtë drejtim, Rregullorja në shqyrtim rregullon dy çështje kryesore: formën dhe përmbajtjen e aplikimit që influencersit duhet të paraqesin në Agjenci për t'u regjistruar në regjistër dhe kriteret që ata duhet të plotësojnë për t'u regjistruar. Ekzistojnë gjashtë kriterë. Kriteri i parë lidhet me atë nëse shërbimi ofrohet përmes platformave të ndarjes së videove, si Instagram, YouTube , TikTok , duke vënë në dukje se fokusi për momentin do të jetë në këto tre platforma. Kriteri i dytë parasheh që shërbimi të ketë karakter ekonomik, përkatësisht të realizohet ndonjë lloj fitimi. Kriteri i tretë i referohet qëllimit të përmbajtjes - duhet të informues, argëtues ose edukativ. Kriteri i katërt ka të bëjë me ekzistencën e përgjegjësisë editoriale. Kriteri i pestë ka të bëjë me shtrirjen - përmbajtja duhet të jetë e destinuar për publikun e gjerë. Versioni fillestar vendosi një prag prej 30.000 ndjekësish, abonentësh ose përdoruesish, por pas konsultimit me industrinë, ku u tregua se kufizimi i tillë do të përjashtonte një numër të konsiderueshëm

krijuesish me ndikim, ai u rishikua në 10.000 ndjekës. I gjashti përcakton që në 12 muajt e fundit të publikohen së paku 24 përmbajtje audiovizuele. Lidhur me kriterin e shtatë të Draft-rregullores, ai është fshirë sepse gjatë punës u konstatua se përfshihej në kriterin e parë. Rregullorja përmban gjithashtu dy shtojca: e para është Formulari i Aplikimit, dhe e dyta i trajton kriteret në detaje. Përveç kësaj, përfshihet dhe "decision tree" - skemë vendimmarrjeje, e cila në mënyrë vizuele shpjegon kriteret, në mënyrë që personat fizik të vlerësojnë më lehtë nëse kanë detyrim për të paraqitur aplikim në Agjenci. Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena D. Dovleva, informoi se vijon faza për përshtatje, në kuadër të së cilës, deri në fund të këtij viti, subjektet do të duhet të regjistrohen. Gjatë së njëjtës periudhë, në bashkëpunim me Agjencinë, ata do të njihen me rregulloret në fuqi dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për personat fizikë që ofrojnë shërbime mediatike audiovizuele me kërkesë (influencues/vlogerë/krijues), me tekstin e propozuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Rregulloren e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 8

Z. Trajçevski në lidhje me Propozimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë dhe SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë, për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), sqaroi se të dy transmetuesit kanë shkëlur të njëjtin nen të Ligjit. Ai theksoi se të dy stacionet televizive kanë kryer të njëjtën shkelje, përkatësisht nuk e kanë përmbushur detyrimin ligjor për të transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, as nuk kanë siguruar së paku gjysmën e këtij programi që transmetohet në periudhën nga ora 07:00 deri në 19:00. Në prezantimin e tij, z. Trajçevski iu referua hulumtimeve konkrete nga raportet e mbikëqyrjes së kryer, ku shihet qartë se të dy stacionet televizive janë nën minimumin ligjor në përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në bazë të kësaj, propozohet që të dy transmetuesve t'u shqiptohet masë paralajmërim publik, duke marrë parasysh se kjo është shkelja e parë e këtij neni të Ligjit në vitin aktual. Përveç kësaj, ka informuar se transmetuesve do t'u jepet afat prej 20 ditësh nga marrja e aktvendimit për të harmonizuar veprimtarinë e tyre me detyrimet ligjore, pas së cilës do të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar harmonizimin e tyre me vendimin e miratuar të Këshillit.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-2463/1 datë 12.6.2025, dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, sepse më 3 qershor 2025, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, as nuk transmetoi së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, transmetuar në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet që në afat 20 (njëzet) ditësh nga dita e marrjes së Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e

saj me dispozitat e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik, të kryej mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 9

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-2465/1 datë 12.6.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë, t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, sepse më 3 qershor 2025, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, as nuk transmetoi së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, transmetuar në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e marrjes së Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështjeve programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik, të kryej mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimi e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 10

Z. Trajçevski dha shpjegim të Propozimit për shlyerjen e kërkesave të vjetruara nga evidenca kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Ai theksoi se në përputhje me Raportin e revizionit, janë identifikuar disa kërkesa nga ish-transmetues, si dhe nga një kompani e huaj - HD European Konsalting Group SHPK Beograd, e cila në të kaluarën ka zbatuar projekt IPA. Të gjitha këto kërkesa janë më të vjetra se tre vjet. Sipas gjetjeve të revizionit, ato duhet të shlyhen nga evidenca, por u theksua se kjo nuk përjashton të drejtën e Agjencisë, nëse krijohen kushte në të ardhmen, të veprojnë në lidhje me pagesën e mjeteve.

Z. Trajçevski sqaroi se për disa nga subjektet, siç janë TV AB Kanal, Sitel 3 dhe Radio Bravo, procedurat po zhvillohen para përmbaruesi, por perspektivat reale për pagesën e detyrimeve janë minimale. Procedurat e falimentimit janë duke u zhvilluar për TV Kanal Vizija dhe TV K-3, ndërsa subjektet MH Radio, KTV Peshna dhe European Konsalting janë subjekte tashmë të likuiduara. Në lidhje me European Konsalting, është theksua se Agjencia kishte dhënë pajisje teknike, për të cilat ishte dhënë një faturë me TVSH të llogaritur në shumën prej 6.272,00 denarë. Megjithatë, ky detyrim nuk ishte përmbushur, ndoshta sepse kompania kishte përjashtim nga TVSH-ja në bazë të aktvenimit nga Ministria e Financave. Ky projekt IPA daton që nga viti 2011 ose 2012, dhe subjekti juridik nuk ekziston më. Në fund të prezantimit të tij, z. Trajçevski informoi se shuma totale e kërkesave të vjetruara që propozohet të shlyhen është 738.488,00 denarë.

Znj. Majnova pyeti se mbi çfarë baze janë krijuar borxhet nga transmetuesit, siç janë AB Kanal, Sitel 3 dhe Radio Bravo.

Z. Trajçevski shpjegoi se borxhet e transmetuesve AB Kanal, Sitel 3 dhe Radio Bravo rrjedhin nga faturat vjetore të papaguara që Agjencia u lëshoi atyre për transmetim. Këto fatura, të cilat kanë të bëjnë me transmetim televiziv ose në radio, duhej të paguheshin në afat prej 30 ditësh. Për shkak të mosrespektimit të këtij detyrimi, Këshilli miratoi vendim për heqjen e lejes të transmetimit. Ai theksoi më tej se Agjencia nuk faturon për të gjithë vitin kalendarik, por vetëm për periudhën në të cilën transmetuesi ka punuar në të vërtetë. Faturat jepen në mënyrë proporcionale me numrin e ditëve deri në ditën e heqjes së lejes (për shembull, për 30 ditë transmetim). Megjithatë, pavarësisht kësaj rrethane lehtësuese, disa transmetues nuk i kanë rregulluar as këto detyrime, për shkak se këto pretendime mbeten të regjistruara në regjistrat kontabël të Agjencisë.

Znj. Vërzivolli bëri një pyetje në lidhje me deklaratën e bërë nga drejtori, duke iu referuar pjesës ku thuhej se për subjekte të caktuara është hapur procedurë falimentimi. Ajo pyeti nëse Agjencia ishte regjistruar si kreditor në pasurinë e falimentimit për kërkesat përkatëse.

Zëvendësja e udhëheqëses së Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, mr. Ivona Mufisheva sqaroi se për TV K-3 është paraqitur denoncim për kërkesë parash. Përveç kësaj, ajo informoi se në të gjitha procedurat e falimentimit, si dhe në procedurat para noteri dhe përmbaruesi, Agjencia ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për të mbrojtur kërkesat e saj.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për shlyerjen nga evidenca kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht shlyerjen e borxhit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizion SITEL 3 SHPKNJP Shkup, në shumë prej 446.357,00 denarë (katërqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë) denarë.

Me shlyerjen e borxhit të lartpërmendur nuk ndalohet procedura e inicuar për pagesën e borxhit. Derisa të paguhet borxhi, i njëjti do të kreditohet në llogarinë e Agjencisë.

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, dhe shlyerja e kërkesës në fjalë do të kryhet pas miratimit të Vendimit.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për shlyerjen e evidencës kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht shlyerjen e borxhit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive AB KANAL SHPKNJP

Shkup, në shumë prej 213.978,00 denarë (dyqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë denarë).

Me shlyerjen e borxhit të lartpërmendur nuk ndalohet procedura e inicuar për pagesën e borxhit. Derisa të paguhet borxhi, i njëjti do të kreditohet në llogarinë e Agjencisë.

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, dhe shlyerja e kërkesës në fjalë do të kryhet pas miratimit të Vendimit.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për shlyerjen nga evidenca kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht shlyerjen e borxhit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive K TRI TELEVISION SHPKNJP Kumanovë, në shumë prej 32.841,00 denarë (tridhjetë e dy mijë e tetëqind e dyzet e një) denarë.

Me shlyerjen e borxhit të lartpërmendur nuk ndalohet procedura e inicuar për pagesën e borxhit. Nëse borxhi paguhet, i njëjti do të kreditohet në llogarinë e Agjencisë.

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, dhe shlyerja e kërkesës në fjalë do të kryhet pas miratimit të Vendimit.

- Këshilli i Agjencisë dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për shlyerjen nga evidenca kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht shlyerjen e borxhit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Vizhn BM-TV KANAL VIZIJA SHPK Shkup, në shumë prej 27.300,00 denarë (njëzet e shtatë mijë e treqind) denarë.

Fshirja e borxhit të lartpërmendur, kryhet për shkak se ndërmarrja afariste SHTR Vizhn BM-TV KANAL VIZIJA SHPK Shkup - në falimentim në pajtim me Aktvendimin e Gjykatës Themelore Civile Shkup I ST-134/23 datë 26.3.2024, mbyllet dhe nuk ka mundësi për shlyerjen e borxhit.

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, dhe shlyerja e kërkesës në fjalë do të kryhet pas miratimit të Vendimit.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për shlyerjen nga evidenca kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht shlyerjen e borxhit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIOBRAVO SHPKNJP Kumanovë, në shumë prej 4.929,00 denarë (katër mijë e nëntëqind e njëzet e nëntë) denarë.

Me shlyerjen e borxhit të lartpërmendur nuk ndalohet procedura e inicuar për pagesën e borxhit. Nëse borxhi shlyhet, i njëjti do të kreditohet në llogarinë e Agjencisë.

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe shlyerja e kërkesës në fjalë do të kryhet pas miratimit të Vendimit.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për shlyerjen nga evidenca kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht shlyerjen e borxhit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Zoran Zdravkoviq MX-

RADIO Ohër SHPKNJP, në shumë prej 3.899,00 (tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) denarë.

Shlyerja e borxhit kryhet për shkak se Shoqëria për prodhim, tregti dhe aktivitete shërbimi KTV PESHNA eksport-import SHPKNJP, Makedonski Brod më 15.2.2019 më shumë se 6 vite është fshirë nga Regjistri Qendror I RMV-së nuk ka mundësi për arkëtimin e tij, duke pasur parasysh se në pajtim me Aktvendimin CT.nr.41/19 datë 27.2.2020 të Gjykatës Themelore të Ohrit, procedura e hapur falimentimi kundër debitorit SHTR Zoran Zdravković MX-RADIO Ohër SHPKNJP nuk po zbatohet dhe është në përfundim e sipër, sepse prona që do të hynte në pasurinë e falimentimit nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet në procedurën e falimentimit.

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, dhe shlyerja e kërkesës në fjalë do të kryhet pas miratimit të Vendimit.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të miratojë Vendim për shlyerjen nga evidenca kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht shlyerjen e borxhit të Shoqërisë për prodhim, tregti dhe aktivitete shërbimi KTV PESHNA eksport-import SHPKNJP, Makedonski Brod në shumë prej 2.912,00 (dy mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) denarë.

Fshirja e borxhit bëhet sepse Shoqëria për prodhim, tregti dhe veprimtari shërbimi KTV PESHNA eksport-import SHPKNJP, Makedonski Brod, më 15.2.2019, është fshirë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë për më shumë se 6 vjet dhe nuk ka mundësi për shlyerjen e borxhit.

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, dhe shlyerja e kërkesës në fjalë do të kryhet pas miratimit të Vendimit.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të miratojë Vendim për shlyerjen nga evidenca kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht shlyerjen e borxhit të HD European Konsaëëting Group SHPK Belograd (HD European Consulting Group). Konsulencë Grupi “ Client ” Limited Liability Company), në shumë totale prej 6,272.00 (gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) denarë.

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, dhe shlyerja e kërkesës në fjalë do të kryhet pas miratimit të Vendimit.

Pika 11

Zëvendës udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, mr.Ivona Mufisheva, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: mirëmbajtja adaptive dhe parandaluese e sistemit të regjistrimit elektronik të rrjeteve të komunikimit publik. Ajo shpjegoi se qëllimi i furnizimit është të sigurojë funksionimin pa pengesë dhe të sigurt të sistemit, nëpërmjet mirëmbajtjes së tij të rregullt. Ajo theksoi se furnizimi është parashikuar në Planin vjetor për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2025. Në lidhje me mjetet financiare, ajo informoi se vlera totale e parashikuar është 280.000,00 denarë (pa TVSH), nga të cilat: 140.000,00 denarë janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2025 , ndërsa 140.000,00 denarë të mbetur do të sigurohen nga

Plani Financiar për vitin 2026, duke marrë parasysh se shërbimi ka të bëjë me një periudhë prej dy vitesh. Ajo theksoi se dhënia e kontratës do të kryhet duke zbatuar një procedurë për furnizim publik me vlerë të ulët, në përputhje me Ligjin për furnizim publik, pa zbatim të ankandit elektronik. Detajet e mbetura përmbahen në materialet që iu dorëzuan anëtarëve të Këshillit për shqyrtim të kësaj pike.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja adaptive dhe parandaluese e sistemit të regjistrimit elektronik të rrjeteve të komunikimit publik.

Zbatimi i procedurës të furnizimit publik për lëndën: Mirëmbajtje adaptive dhe parandaluese e Sistemit të regjistrimit elektronik të rrjeteve të komunikimit publik për 2 (dy) vite është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor të furnizimit publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-2874/1 datë 8.7.2025, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025, përkatësisht do të sigurohen shtesë nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 12

Z. Trajčevski shpjegoi Propozimin për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e 4 (katër) qasjeve përdoruese në bazën elektronike të të dhënave të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut (GZRMV)". Ai shpjegoi se Gazeta Zyrtare është ofertuesi i vetëm, që do të thotë se nuk ka mundësi të zgjidhet furnizues tjetër, por nga aspekt formal dhe juridik, është e nevojshme që Këshilli të japë miratimin për përdorimin e mjeteve financiare me qëllim vazhdimin e qasjeve ekzistuese.

Në këtë drejtim, znj. Majnova bëri një pyetje, duke treguar se ky është shërbim që kushton para dhe se numri i qasjeve është i kufizuar. Ajo pyeti se cilët persona nga Shërbimi Profesional aktualisht kanë qasje në bazën e të dhënave elektronike të GZRMV-së.

Zëvendës-udhëheqësja mr. Ivona Mufisheva shpjegoi se nga gjithsej 4 qasje: 3 përdoren në Sektorin për çështje juridike dhe 1 qasje është destinuar për Sektorin për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit.

Përveç kësaj, znj. Majnova kërkoi që të gjitha vendimet që do të publikohen në GZRMV-së, të cilat lidhen me kompetencat e Agjencisë, t'u dërgohen si njoftim anëtarëve të Këshillit në format PDF ose si imazh.

Z. Trajčevski u përgjigj se Sektori për çështje juridike i informon rregullisht udhëheqësit e sektorëve, drejtorin, anëtarët e Këshillit, kryetarin dhe zëvendës-kryetarin, kur bëhet fjalë për njoftimet dhe ndryshimet në legjislacionin përkatës ligjor, veçanërisht në lidhje me LSHMAAV, Ligjin për Media dhe Kodin Zgjedhor. Ai gjithashtu theksoi se qasjet në GZRMV në sektorin juridik nuk janë individuale, por janë të destinuara për përdorim zyrtar, dhe të gjithë punonjësit që kanë nevojë për informacione ose akte që lidhen me punën e Agjencisë mund t'i përdorin këto qasje.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të miratojë vendim me të cilin miraton mjete financiare në shumë prej 46.000,00 denarë me shumë të llogaritur TVSH 18%, për rinovimin e 4 (katër) qasjeve përdoruese në bazën elektronike të të dhënave të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", për periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Shuma e mjeteve për qasje në bazën elektronike të të dhënave të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" është parashikuar në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Pika 13

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,**

Mr.Sasho STEFANOVSKI